



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0253

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “FRONI 1” SH.P.K., dhe OE “EING COM” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit, Dardani” me numër të prokurimit 616-23-13568-5-1-1, me 18/06/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohen**, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE “FRONI 1” SH.P.K., me nr. 2024/0253, e datës 22/03/2024 dhe OE “EING COM” SH.P.K., me nr. 2024/0270, e datës 27/03/2024, ndërsa vendimi i AK “Komuna e Prishtinës”. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit, Dardani” me numër të prokurimit 616-23-13568-5-1-1.

2. **Anullohet**, njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e Prokurimit: “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit, Dardani” me numër të prokurimit: 616-23-13568-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues, “Komuna e Prishtinës”, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “FRONI 1” SH.P.K., “EING COM” SH.P.K.,

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.12.2023, “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit, Dardani” me numër të prokurimit 616-23-13568-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,235,000.00 €.

Me 06.03.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë GOE “**Selmans Netwoerk & Infra Plus**”.

Me 10.03.2024, OE “FRONI 1” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 11.03.2024 po ashtu edhe OE “EING COM” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 19.03.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 22.03.2024, OE “FRONI 1” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0253/2024 ndërsa me datë 27.03.2024 OE “EING COM” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0270/2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas

nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0253/24 dhe ankesa nr. 0270/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FRONI 1” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

utoriteti kontraktues, në vlerësimin e dosjes së tenderit të Operatoreve ekonomike pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ka anashkaluar disa pika kryesore. **Në vlerësimin e kompanisë: Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K.** - si grup i operatoreve ekonomik, në mospajtim me kriteret për dënimin e kontratës, të shpallura në dosjen e tenderit, ka vlerësuar si të përgjegjshëm këtë GOE. Të gjeturat tona lidhur me këtë GOE janë si në vijim:

1. Asnjëri anëtar i GOE, nuk ka dorëzuar dhe as nuk e ka plotësuar ANEKSIN 6 të dosjes së tenderit, pjesë obligative kjo sipas kriterëve të dosjes së tenderit për të dëshmuar përvojën e punës profesionale të kompanisë.

2. Inxhinierët e prezantuar, nuk kanë përvojë profesionale në lëminë e ekzekutimit të kontratave ndërtimore. Shumica kanë poste politike ose mesimdhënie.

3. Lista e të punësuarve, nuk plotëson kriterin nr.2 pika f, lista e punësuarve për këtë projekt, është me pak se 15 punësuar, sipas kërkesës së dosjes.

4. Pajset e prezantuara, nuk plotësojnë kërkesat e pajseve të specifikuara, përveç 2 pajseve që plotësojnë kriterin, mungojnë pajset si në vijim: ----- Kamion me kran me pesë bartese deri 3 ton - nuk e plotëson

kriterin - mungon ----- Ekskavator mobil - skip - nuk e plotëson kriterin - mungon ----- Lugë ngarkuese deri në 3 ton - nuk e plotëson kriterin - mungon; Miniekavator 1-2 ton me pjesë përcjellese cekan dhe luge - mungon - nuk plotëson kriterin ----- Autoshesha speciale - deri në 3 ton - nuk e plotëson kriterin mungon

5 Ka shperputhje ne mes te deklarimit me shkrim te afatit kohor te kryerjes se punimeve (GOE kane deklaruar se per 240 dite do te kryejne punimet) ndersa ne planin dinamik te ofruar kane prezantuar 238 dite, qe nenkupton, se ky GOE nuk mund te poentohet sipas kriterit te dosjes ku thuhet se afati minimal duhet te jete 240 dite. te gjitha mangesi ne deshmimin e kapacitetit profesional te kompanise se referuar si ofertues i suksesshem, jane te mjaftueshme per te eliminuar kete GOE pasi eshte i papergjegjshem per tu kualifikuar per kete kontrate

Te gjeturat per OLTİ TRASİNG SHPK -

1. Ne dosjen e tenderit, kerkohet qe paisjet te cilat merren me qera per kete projekt, duhet te deshmohen me marreveshje te noterizuar ne mes te qiradhenesit dhe qiramarresit. Kompania ne fjale nuk e ka te noterizuar ne mes te qiradhenesit dhe qiramarresit. por vetem nje person ka noterizuar kontratat - mos permbajtje e kriterit ne teresi.

2. Kompania kur ka prezantuar paisjet, nuk ka paraqitur dokumentat adekuate per ekskavatorin 1 deri 2 ton, por vetem nje fature e cila eshte leshuar ne muajin e 11 te vitit 2023. pervec kesaj edhe ne fature nuk ka paraqitur se jane edhe luga dhe cekani si pjese percjellese dhe kerkese e dosjes se tenderit.

3. Mungon autofshesa deri 3 ton, sipas kerkeses se dosjes se tenderit.

4. Ka shperputhje ne mes te deklarimit me shkrim te afatit kohor te kryerjes se punimeve (GOE kane deklaruar se per 240 dite do te kryejne punimet) ndersa ne planin dinamik te ofruar kane prezantuar 224 dite, qe nenkupton, se ky GOE nuk mund te poentohet sipas kriterit te dosjes ku thuhet se afati minimal duhet te jete 240 dite. Per operatorin ekonommik ALFA I, ne nuk jemi marr fare, meqe Autoriteti Kontraktues e ka vleresuar si te papergjegjshem.

Lidhur me OE EING COM, edhe pse eshte me cmimin me te larte, gjithashtu, ka mangesi ne dosjen e prezantuar:

1. Mungon plani dinamik

2. Mungon autofshesa me peshe maksimum 3 ton. Ne nuk kemi hulumtuar, por sikur te studionim me shume do te gjenim akoma te gjetura. Prandaj, parashtojme kete kerkese prane Autoritetit Kontraktues - qe te rishqyrtoje kete dosje dhe te ktheje lenden ne rivleresim duke dhene vendimin meritor se operatori i vetem i pergjegjshem per kete procedure prokurimi eshte GOE - FRONI 1 SHPK dhe ILEAA GR SHPK

Fillimisht, duhet të theksohet se Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk ka dhënë përgjigje në asnjë nga pretendimet e OE Ankues, duke anashkaluar në tërësi dhe në mënyrë të qëllimshme pretendimet valide dhe të qëndrueshme të ngritura në kërkesën për rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës në mënyrë të qëllimshme kufizohet vetëm në një arsyetim shabllon, me qëllim të kamuflimit të kërkesave të cilat nuk janë plotësuar nga OE Fitues dhe nga OE tjera konkurente në këtë aktivitet të prokurimit. Nëse Autoriteti Kontraktues do të lëshohej në elaborimin e përmbushjes së kritereve nga OE Fitues dhe OE tjera atëherë do të ishte e qartë se kriteret e vendosura në dosjen e tenderit nuk janë plotësuar, dhe OE i vetëm i cili i plotëson të gjitha kriteret është OE Ankues Froni 1 Sh.P.K.

Me këto lëshime të qëllimshme, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku theksohet se autoriteti shtetëror duhet të ofrojë arsyetim lidhur me faktet vendimtare të rastit të ngritura nga pala si dhe të ofrojë bazën ligjore se pse një pretendim i palës ankuese është i bazuar apo nuk është i bazuar. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë argument lidhur me pretendimet e OE Ankues.

OE Ankues ka ngritur pretendimet lidhur me mos-plotësimin e Aneksit 5 të DT, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë sqarim për mos-plotësimin e Aneksit nga ana e OE Fitues. Poashtu, OE Ankues ka theksuar se inxhinieret nuk kanë përvojë profesionale në implementimin e kontratave ndërtimore, përveç titullit inxhinier, meqë shumica kanë mbajtur poste politike dhe administrative, por as ky pretendim nuk është arsyetuar apo elaboruar në Autoriteti Kontraktues. Poashtu, plani dinamik i OE Fitues ka përcaktuar që projekti duhet të kryhet brenda 238 ditësh, edhe pse kërkesa dhe poentimi janë bazuar dhe varur nga fakti që projekti duhet të implementohet brenda afatit prej 240 ditësh jo më herët apo më vonë.

Kriter tjetër i paplotësuar nga OE Fitues është edhe mungesa e mjeteve të punës, ku në kërkesën për rishqyrtim janë rënditur qartë se mungojnë: (i) kamioni me kran me peshë bartëse deri tre ton; (ii) eskavatori mobil/skip; (iii) lugëngarkuese deri tre ton; (iv) minieskavator 1-2 me pjesë përcjellëse dhe lugë. Megjithatë, të gjitha këto pretendime kanë mbetur në ajër dhe nuk janë marrë parasysh fare nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të shkakimit të dëmit ndaj OE Ankuesi Froni 1 Sh.P.K.

Poashtu, Autoriteti Kontraktues nuk është marrë fare as me pretendimet ankimore ndaj OE Olti Trasing edhe pse të njëjtat janë tërësisht të bazuara dhe sjellin eliminimin e këtij OE Olti Trasing nuk ka prezantuar çertifikatën valide EN 45001:18, për shkak se në vet çertifikatën e bashkëngjitur është e shkruar qartë se kjo çertifikatë mbetet e vlefshme me anën e kryerjes me sukses të mirëmbajtjeve vjetore brenda ciklit të çertifikimit. Çertifikata ISO EN 45001:18 është lëshuar me datë 04 mars 2022, kurse OE Olti Trasing nuk ka ofruar dëshmi se ka kryer mirëmbajtjen vjetore e cila në bazë të kërkesës së AK është dashur të bëhet deri me datën 04 mars 2023. Pa e kryer mirëmbajtjen, Çertifikata ISO EN 45001:18 nuk vazhdohet automatikisht, rrjedhimisht për OE Ankues, çertifikata e OE Olti Trasing është e skaduar.

Kontrata me inxhinerin e makinerisë Xhevdet Hetemi është Kontratë për Punë të Veçanta dhe nuk është Kontratë Pune e përpiluar në bazë të Ligjit të Punës por është përpiluar në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Sipas Kërkesës Nr. 2 në Dosjen e Tenderit, nëse marrëveshja më inxhinerin është vetëm për këtë projekt, duhet të jetë kopje e vërtetuar nga origjinali pranë zyrës noteriale. Në rastin konkret, Kontrata e Inxhinerit të Makinerisë Xhevdet Hetemi nuk është e noterizuar dhe nuk plotëson kriterin e vendosur nga AK. Çfarëdo ndryshimi i mëvonshëm, do të devijonte nga ky kusht esencial, meqë një Kontratë nuk mund të vërtetohet retroaktivisht – andaj edhe ky kriter nuk është plotësuar nga OE Olti Trasing.

Kontrata në mes të OE Olti Trasing dhe Blerim Reka për qeradhënien e pajisjes Kiper me dy dyer, të tipit Nissan, nuk i përmbushë kriteret, për shkak se në Kontratë nuk theksohet se për çfarë pajisje është fjala. E njëjta vlen edhe për qeradhënien e Kamionit me vinç me dy dyer, të dhënë me qera nga Titan Construction Sh.P.K., ku nuk theksohet se cila është makina/pajisja e dhënë me qera.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE "FRONI 1" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56, paragraf 1,3, 59, 60, 64 Neni 60 Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale të LPP-së . Andaj, kërkojmë nga OSHP që të aprovojë si të bazuar ankesën e OE Froni 1 Sh.P.K., ta kthejë edhe njëherë këtë aktivitet të prokurimit në rivlerësim dhe të shpallet si ofertues i suksesshëm, si ofertuesi i vetëm i përgjegjshëm dhe të shpërblehet me kontratë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE "FRONI 1" SH.P.K., Lidhur me pretendimet ankimore të "FRONI 1" Sh.P.K është gjetur si në vijim:

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi ka parashtruar dy grupe të pretendimeve ankimore. Grupi i parë i pretendimeve ankimore janë dorëzuar kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë GOE "Selmans Network & Infra Plus" ndërsa grupi i dytë i pretendimeve ankimore janë parashtruar kundër tenderuesve të tjerë të papërgjegjshëm apo të pasuksesshëm të cilët nuk janë rekomanduar për kontratë.

Sa i përket grupit të parë të pretendimeve ankimore nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se oferta është dorëzuar në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, duke përfshirë këtu edhe kërkesat lidhur me stafin dhe makineritë të kontestuara sipas pretendimeve ankimore të parashtruesit. Pra të gjitha pretendimet ankimore në grupin e parë janë të pabazuara në tërësi.

Sa i përket grupit të dytë të pretendimeve ankimore, parashtruesi nuk mund të dëshmojë asnjë interes material në raport me këto pretendime ankimore pasi që këta tenderues nuk janë rekomanduar për kontratë prandaj parashtrimi i pretendimeve ankimore kundër këtyre tenderuesve nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik prej të cilit do të mund të kishte interes material parashtruesi. Rrjedhimisht është gjetur se parashtruesi në raport me grupin e dytë të pretendimeve ankimore nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par, 1 nënpar. 26 të LPP ku përcaktohet se "Palë e interesuar -- personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me fljë kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një Shkelje e pretenduar"

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 621. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EING COM" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Me datë; 06.03.2024 kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të ngakruar në platformën e-prokurimi si dhe Letren Standarde për Tenderuesin e Pasukseshëm. Po në këtë datë ne kemi kërkuar qasje e dokumentacionin tenderit të OE të propozuar për dhënie dhe OE pjesmarrës në këtë aktivitet. Qasja na është mundësuar me datë; 08.03.2024 gjatë orarit të punës. Në qasje ne kemi kërkuar që të na jepet kopje e materialit të OE të propozuar për dhënie të kontratës, OE pjesmarrës në këtë aktivitet.

Gjatë analizës të dokumentacionit të dorëzuar të tenderit nga ana e OE pjesmarrës në këtë procedurë ne kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit pranë AK-se ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-se dhe rregullave të UOPP-se,

Me dt. 19.03.2024 kemi njoftuar se kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga ana jonë është refuzuar duke mos arsyetuar pretendimet tona.

Theksojm se kerkesa per rishqyrtim nuk eshte shqyrtuar brenda afatit ligjor prej 3 dite pune + 3 dite shtese pa na njoftuar po qe se as brenda ketyre diteve ku kerkesa per rishqyrtim eshte dorezuar me dt.11.03.2024 ndersa vendimi per refuzimeshte pranuar me dt.19.03.2024.

Sipas vendimit per refuzim te kerkeses per rishqyrtim shihet qarte se AK i ka trajtuar shkarazi dhe ne menyre selektuve pretendimet dhe faktet e paraqitura ne kerkesen per rishqyrtim nga ne ashtu qe duke u shmangur detyrimeve ligjore dhe duke anashkaluar faktet vendimtare dhe rrethanave te rastiti konkret ka paraqitur pasqyrim te gabuar te gjendjes faktike qe nuk perkon me ralitetin, rrjedhimisht e ngaterron gjendjen e sakte faktike dhe pershkrim.it ligjor ne menyre qe OE ankues tia mohoj te drejten ne rivlersim real te procesit me qellim qe te krijoj pershtypje se asgje e paligjshme nuk ka ndodhur.

Nga ky arsytim i vendimit te atakuar nuk e ka vertetuar sakte dhe drejte gjendjen faktike dhe rrjedhimish eshte zbatuar ne menyre te gabuar e drejta e dispozitave materiale te LPP-se perfshir edhe keqinterpretimin e tyre dhe kerkesave te dosjes se tenderit, duke qene se arsyet e dhena ne vendimiu e AK-se nuk jane te bazuara ne LPP dhe RRPP Nr.001/2022, per me teper arsytimi i vendimit te AK-se eshte ne kundeshitim edhe me percaktimet e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 te Ligjit Nr.05/L-031 per Proceduren e Pergjithshme Administrative, sepse pretendimet tona ankimore jane cek ne kerkesen per rishqyrtim te OE tjeter pjesmarres qe ka paraqit kerkes per rishqyrtim andaj kerkesa per rishqyrtim nga ana jone nuk eshte ajo e cekura ne vendimin per refuzim sepse nuk jane shqyrtuar pretendimet tona ankimore por siperfaqesisht sa per tu llogarit refuzim i kerkeses. Gjithashtu eshte I pa bazuar konstatimi I AK-se I dhene ne vendimin per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim me arsytimin se kinse OE ankues nuk e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4,1.26 të LPP-së. Kjo për faktin se OE ankues i plotëson të gjitha kushtet që dëshmon se është palë me interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së, sepse në radhë të parë oferta e tij është e përgjegjshme, dhe pastaj përveq pretendimeve karrshi GOE fitues, kemi paraqihjr pretendime me prova dlje fakte relevante edhe për tenderin e OE "OLT1 TRASNG"SH.P.K., pastaj per OE "ALFA.i" SH.P.K e po ashtu edhe per GOE "FRONI1" SH.P.K. & "ILEAA-GR" SH.P.K. oferta c të cilit është radhitur më e lirë se sa oferta e OE ankues. Andaj, duke u bazuar në ato që u thanë më lartë, OE ankues i plotëson kushtet e statusit të palës ine interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së, sepse është palë që dëshmon interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit, respektivisht për tu propozuar rneshpërblim të kontrates.

Duke pare që AK nuk ka ndërmarr veprime që kane pë qellim zgjidhjen e drejte e të ligjshme ne detyrohemi ti drejtohem OSHP-së permes kesaj ankese me qellim qe pretendimet dhe faktet e paraqitura ne kerkesen per rishqyrtim perfshir edhe pretendimin kunder vendimit per refuziin te kerkeses per rishqyrtim te shqyrtohen dhe vlersohen ne menyre te drejte nga paneli shqyrtues,

Ne vijim po ju paraqesim në mënyre të detajuar faktet dhe argumentet te cilat AK nuk i ka respektuar me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te tenderëve. Infra-plus SH.P.K.;

Andaj në vështrim të gjendjes faktike dhe në vështrim të bazës ligjore, shkeljet konsistojnë ne faktet dhe rrethanat e cekura siç janë pasqyruar në objektin e pretendimeve dhe atë per arsyet si në vijim:

Prefendimi Nr. 1 GOE nuk ka plotësuar kërkesat administrative pasi nuk ka plotësuar formularin e tenderit si duhet. Çmimi total i tenderit është: 941/133.28 Euro ndersa sipas tabelës nuk është plotësuar siq duhet. Sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik/ Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo numgon/ Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm/Kusht administrativ

3. Çmimi total i tenderit është: 941,133.28 EUR

Pra çmimi i dhënë në pikë 3 nuk korospondon me çmimin e dhënë në pozicionin të tabelës.

Po i njejtë AK - Komuna e Prishtinës per gabimet e njejtë në pershkrimin e çmimeve ka eliminuar OE ne projektin me titull: Ndertimi i kolektorit te vazhdimi i rruges B (faza 4), andaj AK nuk ka vlersuar drejte edhe ne rastin tone duke perdor standarde te dyfishta.

Pretendimi Nr. 2: “Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj certifikatat ISO STANDARD si në vijim a)ISO 14001 2015/ b) ISO 45001 2018, c) ISO 9001-2015

Dëshmia:3. Kopje e Certifikatave ISO14001 2015/ ISO 45001 2018/ ISO 9001-2015 me validitet. Çertifikatat ISO janë ofruar vetem nga lideri i grupit, mirpo nuk ka paraqit ISO standardet dhe per anëtarin e grupit, duke u bazuar ne Rregulloren Nr.001/2023 për Prokurim Publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik, paragrafi 26.6 .6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë/ përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe te pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standartet përkatëse.

Pretendimi nr.3 Kërkësa 5.Lista e mjeteve, stabilnenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 7 te DT. Dëshmia e kërkuar: OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 chike i bashkangjitur librezë valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrveshje të noterizuar në mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Sipas kërkesës së AK është kërkuar Kamion me kran me peshë bartëse deri 3 t, OE ka ofruar kamion kiper me targa 01-376-JG ku pesha maximale për këtë kamion sipas librezes shihet që është 13300 kg apo 13.3t, dmth që OE nuk ka ofruar makinerin në fjalë sipas kërkesës së AK-së sepse është kërkuar pesha totale dhe jo pesha e ngarkesës.

Për makinerit:

3. Eskavatormobil - Skip,
4. Lugë ngarkuese deri në 3 t.
7. Mjet vetëshkarkues (dainper) 2-3 m3

OE nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit për paisjen në fjalë ku kerkese ka qene që duhet ti bashkangjitet librezë valjde.

Të gjitha makinerit të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr, 05/1.-132 ligji per automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit.

6.Auto fshese speciale deri në 3t, OE ka ofruar kamion për pastrimin e rrugëve nga bora me targa 03-842-EE ku pesha maximale për këtë kamion sipas librezes shihet qe është 5000 kg apo 5t, dmth që OE nuk ka ofruar makinerin në fjalë sipas kërkesës së AK-së sepse është kërkuar pesha totale dhe jo pesha e ngarkesës.

Si përfundim G.O.E. "SELMANS NETVVORK SH.P.K.& Infra-Plus SH.P.K., nuk ka plotësuar kërkesat mbi inondësitë teknike dhe/ose profesionale andaj duhet të vlersohet si i papërgjegjshem.

Faktet dhe argumentet te cila nuk I ka plotsuar OE Alfa.I SH.P.K Ky OE është i papërgjeshëm nga ana c komisionit vlersnes ku nuk ka plotesuar kërkesat administrative 9.1&9.2, ku nuk ka dorëzuar dokumentet per menaxherin e projektit sipas kërkesës së AK-së, referuar B45 Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar të dt.06.03.2024

Faktet dhe argumentet te cilat nuk I k aplotsuar OE Olti Trasing SHPK

Kërkesa 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 7 te DT.

Dëshmia e kërktar: OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 diike i bashkangjitur librezq valide. Në rast te marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Pretendimi.Nr. 1

*Sipas kërkesës së AK është kerkuar:

1.Kamion kiper me peshe bartëse deri 6t, OE ka ofruar KONTRATË PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PAISJES - për makinierm kamionet kiper me targa 01-73LQT, ku si kërkesë ka qenë që: Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar ttë mes të

qiradhënësit dhe qiramarrësit. OE ka dorëzuar noterizimin nga kopja e zakonshme dhe nuk cek askund që dokumenti është noterizuar ne prezencë të Noterit në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, andaj kjo kerkese nga ana e OE nuk është plotësuar,

Pretendimi Nr. 2

2.Kamion me kran me peshë bartëse deri 3 t, OE ka ofruar KONTRATË PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PAISJES - për maldnierin kamionet kiper me targa 06-177-EG, ku si kërkesë ka qenë që: Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

OE ka dorëzuar noterizimin nga kopja e zakonshme dhe nuk cek askund që dokumenti është noterizuar ne prezencë të Noterit në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, andaj kjo kerkese nga ana e OE nuk është plotësuar.

Pretendimi Nr. 3

3.Eskavator mobil - Skip, OE ka ofruar KONTRATË PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PAISJES - për makinierin Skip, ku si kërkesë ka qenë që: Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit OE ka dorëzuar noterizimin nga kopja e zakonshme dhe nuk cek askund që dokumenti është noterizuar në prezencë të Noterit në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, andaj kjo kërkesë nga ana e OE nuk është plotësuar,

Pretendimi Nr. 4

4.Lugë ngarkuese deri në 3 t., OE ka ofruar KONTRATË PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PAISJES - për makinierin Lugë ngarkuese deri në 3 t., ku si kërkesë ka qenë që: Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. OE ka dorëzuar noterizimin nga kopja e zakonshme dhe nuk cek askund që dokumenti është noterizuar në prezencë të Noterit në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, andaj kjo kërkesë nga ana e OE nuk është plotësuar. Po ashtu OE nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit për paisjen në fjalë ku kërkesë ka qenë që duhet të bashkëngjitet librezë valide. Të gjitha makinerit të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr, 05/L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit.

Pretendimi Nr. 5

6.Auto fshese speciale deri në 3tz OE ka ofruar KONTRATË PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PAISJES - për makinierin Autofshese speciale deri në 3 t., ku si kërkesë ka qenë që: Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

OE ka dorëzuar noterizimin nga kopja e zakonshme dhe nuk cek askund që dokumenti është noterizuar në prezencë të noterit në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, dhe po ashtu për makinierin: Traktor me fshis nuk i ka bashkëngjitur librezën e qarkullimit sipas kërkesës së AK-së, ndërsa sipas KONTRATËS PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PAISJES - kjo paisje nuk plotëson kërkesën e AK-së.

Pretendimi Nr. 6

7.Mjet vetëshkarkues (damper) 2-3 m3 OE ka ofruar KONTRATË PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË PAISJES - për makinierin Mjet vetëshkarkues (damper) 2-3 m3. , ku si kërkesë ka qenë që: Në rast të

marrjes me qira dtihet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

OE ka dorëzuar noterizimin nga kopja e zakonshme dhe nuk cek askund që dokumenti është noterizuar në prezencë të Noterit në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit

OE nuk ka dorëzuar librezën e qarkul.li.in.it për paisjen në fjalë ku kerkese ka qene që duhet të bashkangjilet librezat valide.

Të gjitha makinerit të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr, 05/L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit.

Faktet dhe argumentet të cilat nuk i ka plotësuar GOE Froni I SHPK & Ilea-Gr SHPK

G.O.E, nuk ka plotësuar kërkesat administrative sipas 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a, është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b, është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c, është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

G.O.E. ka ofruar Validitetin e ofertës në kundërshtim me kërkesën në Dosjen e Tenderit - FTD - Neni 21.1 ku kërkesa ka qenë: Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 120 dite, ndërsa G.O.E. ka ofruar validitetin e ofertës në periudhë 150 ditë.

Kerkesa 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 7 të DT.

Dëshmia e kërkuar; OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke 1 bashkangjittir libreza valide. Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me maxrëveshje te noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramanesit

Pretendimi Nr. 1

3.Eskavator mobil - Skip, OE nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit për paisjen në fjalë ku kerkese ka qene që duhet ti bashkangjitet libreza valide, Të gjitha makinerit te cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05/L-132 ligji per automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit.

Pretendni Nr. 2

4.Lugë ngarkuese deri në 3 t, OE nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit për paisjen në fjalë ku kerkese ka qene që duhet ti bashkangjitet libreza valide. Të gjitha makinerit të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05/L-132 ligji per automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit.

Pretendni Nr, 3

6.Auto fshese speciale deri në 3t, OE nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit për paisjen në fjalë ku kerkese ka qene që duhet ti bashkangjitet libreza valide. Te gjitha makinerit te cilat i nënshtrohen Ligjit Nr, 05/L-132 ligji per automjete? duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit.

Pretendimi nr. 4

7.Mjet vetëshkarkues (damper) 2-3 m3 OE nuk ka dorëzuar librezën e qarkullimit për paisjen në fjalë ku kerkese ka qene që duhet ti bashkangjitet libreza valide. Të gjitha makinerit të dhe i nënshtrohen LIGJI Nr. 05/ L-132 ligji per automjete, duhet të jenë të regjistruar dhe me afat të regjistrimit.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi “EING COM” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, parag 2, 7 parag 2 dhe 4, 59 parag 2 dhe 4, 60 parag 1, 65 parag 4.3 dhe 4.8 dhe 69 të LPP-së. Duke propozuar qe të APROVOHET si e bazuar ANKESA e OE "EING COM" SH.P.K.,ANULOHET B58 Njoftim mbi vendimin e

Autoritetit Kontraktuesë datës: 06.03.2024 , Lënda te kthehet në RIVLERËSIM duke marrë në konsiderat të gjitha gjetjet të cilat janë lartcekur dhe me rastin e rivlersimit të jete ne harmoni me kërkesat ligjore si dhe kerkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “EING COM” SH.P.K Lidhur me pretendimet ankimore të EING COM" Sh.P.K. është gjetur si në vijim:

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi ka parashtruar dy grupe të pretendimeve ankimore. Grupi i parë i pretendimeve ankimore janë dorëzuar kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë GOE "Selmans Network & Infra Plus" ndërsa grupi i dytë i pretendimeve ankimore janë parashtruar kundër tenderuesve të tjerë të papërgjegjshëm apo të pasuksesshëm të cilët nuk janë rekomanduar për kontratë.

Sa i përket grupit të parë të pretendimeve ankimore nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se oferta është dorëzuar në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, duke përfshirë këtu edhe kërkesat lidhur me stafin dhe makineritë të kontestuara sipas pretendimeve ankimore të parashtruesit. Pra të gjitha pretendimet ankimore në grupin e parë janë të pabazuara në tërësi.

Sa i përket grupit të dytë të pretendimeve ankimore, parashtruesi nuk mund të dëshmojë asnjë interes material në raport me këto pretendime ankimore pasi që këta tenderues nuk janë rekomanduar për kontratë prandaj parashtrimi i pretendimeve ankimore kundër këtyre tenderuesve nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik prej të cilit do të mund të kishte interes material parashtruesi. Rrjedhimisht është gjetur se parashtruesi në raport me grupin e dytë të pretendimeve ankimore nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP ku përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike Ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë Ose mund të jetë të rrezik të dëmtimit nga një Shkelje e pretenduar.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0253/2024 ndërsa me datën 29.03.2024 ankesen me nr 0270/2024.

Lidhur me ankest nr. 0253/24 me datën 03.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Lidhur me ankest nr. 0270/24 me datën 10.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës me nr.0253/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0270/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE Pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “FRONI 1” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0253 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit „Dardani”, me numër të prokurimit: 616-23-13568-5-1-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,235,000.00 €

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 06.12.2023, Ndërsa Formulari standard për korrigjimin e gabimeve B54 ne njoftimet e publikuara me datë 04.01.2024, 12.01.2024, 23.01.2024, 25.01.2024 dhe - 02.02.2024.

AK me datë 06.03.2024 ka publikuar Vendimin dhe Letrat Standarde per OE-të, kundër vendimit të AK-së me datë 10.03.2024, OE “FRONI 1” SH.P.K., ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së .Ndërsa, AK me datë 19.03.2024 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 22.03.2024 OE “FRONI 1” SH.P.K. ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2024/0253 në pajtim me nenin 114 të LPP së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

AK me datë 06.03.2024, përmes Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Letrës standarde, ka njoftuar Operatorët Ekonomik pjesëmarrës për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, njëherit edhe parashtruesi i ankesës OE “FRONI 1” SH.P.K. është njoftuar me rezultatin për këtë aktivitetit të prokurimit. Sipas vendimit te lartcekur të AK-së OE ankues është i pasuksesshëm me 85.94% te pikëve te fituara.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, “Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk ka dhënë përgjigje në asnjë nga pretendimet e OE Ankues, duke anashkaluar në tërësi dhe në mënyrë të qëllimshme pretendimet valide dhe të qëndrueshme të ngritura në kërkesën për rishqyrtim”.

Eksperti shqyrtues sqaron se, AK ne refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nuk ka dhene sqarime konkrete ne pretendimet ankimore. Sipas paragrafit 9 te nenit 108/A te LPP-se, percaktohet qartë se, “Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti

kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim”.

Gjithashtu kurdo që refuzohet një kërkesë për rishqyrtim, edhe neni 62.2 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton:

“62.2 Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit.

Pretendimi ankimor 1: “OE ankues pretendon se Autoriteti kontraktues, në vlerësimin e dosjes së tenderit të Operatoreve ekonomike pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ka anashkaluar disa pika kryesore.

Në vlerësimin e kompanisë: Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K. - si grup i operatoreve ekonomik, në mospajtim me kriteret për dënimin e kontratës, të shpallura në dosjen e tenderit, ka vlerësuar si të përgjegjshëm këtë GOE. Të gjeturat tona lidhur me këtë GOE janë si në vijim:

1. Anshëri anetar i GOE, nuk ka dorëzuar dhe as nuk e ka plotësuar ANEKSIN 6 të dosjes së tenderit, pjesë obligative kjo sipas kriterëve të dosjes së tenderit për të dëshmuar përvojën e punës profesionale të kompanisë”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 1:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale: “1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 1,235,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve, nëse kontrata është me kompani private të deshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është kry pagesa)”.

Bazuar në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues OE “FRONI 1” SH.P.K., kundrejt OE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, ku thuhet se “Asnjëri anëtar i GOE, nuk ka dorëzuar dhe as nuk e ka plotësuar ANEKSIN 6 të dosjes së tenderit, pjesë obligative kjo sipas kriterëve të dosjes së tenderit për të deshmuar përvojën e punës profesionale të kompanisë”, lidhur me këtë pretendim ankimor, Eksperti shqyrtues sqaron se, gjatë shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të lëndës, në ofertën e paraqitur nga GOE të rekomanduar për kontratë shihet se të dy anëtarët nga ky grup-konzorcium “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K” kanë dorëzuar nga një listë të kontratave të realizuara, në listën e kontratave të realizuara të paraqitura nga anëtarët e këtij grupi “Selmans Network SHPK” lista e kontratave të përmban të dhënat identike me tabelën sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit. Andaj si të tilla konsideroj se përmbajnë elementet thelbësore të cilat kërkohen në Aneksin 6 sipas kërkesës së dosjes së tenderit. ndërsa, sa i përket listës së kontratave të realizuara të prezantuara nga anëtarët tjetër të këtij grupi OE “Infra-Plus SH.P.K” lista e kontratave është paraqitur në një format tjetër, megjithatë përmban elementet baze si dëshmi për kontratat e realizuara.

Vlen të ceket se, njësoj është dorëzuar edhe lista e kontratave të realizuara nga anëtarët e grupit të OE ankues përkatësisht OE-ILEAA GR SHPK, në të cilën nuk tabelë sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit, megjithatë përmban elementet baze si dëshmi për kontratat e realizuara ashtu siç përcaktohen në tabelën sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit.

Pra, sa i përket këtij pretendimi ankimor konsideroj se, meqenëse lista e kontratave është dorëzuar, mos plotësimi i tabelës sipas Aneksit 6 të dosjes së tenderit e duke qenë se janë dhënë

te gjitha elementet baze sipas aneksit 6, mund të konsiderohet edhe si devijim i vogël, megjithatë për çdo paqartësi lidhur me listën e kontratave, AK mund të kërkon sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Për më tepër, “Lista e Kontratave” përmendet në nenin 69 të LPP-së, prandaj, për çdo dëshmi të kërkuar sipas nenit 65-71 të këtij ligji, AK mund të kërkojë sqarime shtesë nga OE-të në përputhje me nenin 72 të LPP-së.

Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të këtij ligji, AK-të mund të kërkojnë nga OE-të që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Andaj, bazuar në sqarimet e cekura me lartë, pretendimi i OE ankues kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se, “2. Inxhinieret e prezantuar, nuk kanë përvojë profesionale në lëminë e ekzekutimit të kontratave ndërtimore. Shumica kanë poste politike ose mesimdhënie”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 2:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale: “2. OE duhet të prezantojë stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt si në vijim a) Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimitarisë drejtimi - konstruktiv - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit. b)

Një (1) Inxhinier i Diplomuar i Arkitektures min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit. c) Një (1) Inxhinier i Diplomuar i hidroteknikës me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit. d) Një (1) Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit. e) Një (1) Inxhinier i Diplomuar i makinerisë - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit. f) Së paku 15 punëtor për kryerjen e punëve në teren..

Dëshmia e kërkuar dokumentare:2.Për piken a -e OE të ofroj dëshmi kopjen e diplomës universitare të noterizuar nga origjinali (noterizimi të mos jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e njoftimit për kontratë) apo nëse OE i ka të regjistruar në listën e pagave në Administratën Tatimore të Kosovës nuk ka nevojë të noterizohen, CV-ja, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt atëherë marrëveshja duhet të jetë kopje e noterizuar nga origjinali si dhe referencat për punën e punës . AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara. f) Lista e punetoreve dhe kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt.”.

Bazuar në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues OE “FRONI 1” SH.P.K., kundrejt OE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, ku thuhet se, “Inxhinieret e prezantuar, nuk kanë përvojë profesionale në lëminë e ekzekutimit të kontratave ndërtimore. Shumica kanë poste politike ose mesimdhënie”, Eksperti shqyrtues sqaron se, sa i përket pikës a që ndërlidhet me kërkesat për inxhinieret, AK në kërkesën e dosjes së tenderit përveç tjerash ka kërkuar që inxhinieret e diplomuar me drejtimet përkatëse të kenë së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, gjithashtu ka kërkuar kopjen e diplomave si dhe referencat për përvojën e punës prandaj, AK në dosjen e tenderit nuk ka kufizuar se inxhinieret duhet të dëshmojnë përvojë specifike në lëminë e ekzekutimit të kontratave ndërtimore.

Pra duke qenë se, AK në dosjen e tenderit përveç kërkesave të lartcekura, nuk ka kufizuar se inxhinieret duhet të dëshmojnë përvojë specifike në lëminë e ekzekutimit të kontratave ndërtimore, prandaj bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit inxhinieret e prezantuar në listën e OE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K” me dëshmitë përkatëse e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pabazuar.

Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton:“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të

diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se, “3. Lista e të punësuarve, nuk plotëson kriterin nr.2 pika f, lista e punetoreve për këtë projekt, është me pak se 15 punetore, sipas kërkesës së dosjes”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 3: “Lidhur me këtë pretendim ankimor të OE ankues OE “FRONI 1” SH.P.K., kundrejt OE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, ku thuhet se, “3. Lista e të punësuarve, nuk plotëson kriterin nr.2 pika f, lista e punetoreve për këtë projekt, është me pak se 15 punetore, sipas kërkesës së dosjes”, Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, sqaron se, sa i përket pikës f) AK në kërkesën e dosjes së tenderit ka kërkuar “së paku 15 punëtor për kryerjen e punëve në teren”, ndërsa lista e stafit e prezantuar nga GOE “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K” përbehet nga 21 persona, pjesë e kësaj liste të paraqitur nga GOE i rekomanduar janë inxhinieret dhe punëtorët të cilët angazhohen për këtë projekt, rrjedhimisht e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pabazuar.”

Pretendimi ankimor 4: OE ankues pretendon se, “4. Paisjet e prezantuara, nuk plotësojnë kërkesat e paisjeve të specifikuara, përveç 2 paisjeve që plotësojnë kriterin, mungojnë paisjet si në vijim: ----- Kamion me kran me peshe bartese deri 3 ton - nuk e plotëson kriterin - mungon --- -- Ekskavator mobil - skip - nuk e plotëson kriterin - mungon ----- Lugë ngarkuese deri në 3 ton - nuk e plotëson kriterin - mungon; Miniekskavator 1-2 ton me pjesë përcjellese cekan dhe luge - mungon - nuk plotëson kriterin ----- Autofshese speciale - deri në 3 ton - nuk e plotëson kriterin mungon”

Përgjigje Pretendimit ankimor 4: “Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, lidhur me këtë sqarojmë si në vijim: Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nën 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:“ 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 te DT.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

5.OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur libreza valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit”.

Lidhur me kete pretendim ankimor të OE ankues OE “FRONI 1” SH.P.K., kundrejt OE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, ku thuhet se,

“-mungojne paisjet si ne vijim:

- Kamion me kran me peshe bartese deri 3 ton - nuk e ploteson kriterin

- mungon ----- Ekskavator mobil - skip - nuk e ploteson kriterin”

- mungon ----- Lugë ngarkuese deri ne 3 ton - nuk e plotëson kriterin

- mungon; Miniekskavator 1-2 ton me pjese percjellese cekan dhe luge

- mungon - nuk ploteson kriterin ----- Autofshese speciale - deri ne 3 ton - nuk e ploteson kriterin mungon”.

Bazuar ne kërkesën e lartcekur ne dosjen e tenderit, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht ofertës se OE te rekomanduar, Eksperti shqyrtues sqaron se, lista e pajisjeve e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate e përshkruar me te dhëna rreth pajisjeve përkatëse si dhe ka prezantuar

edhe disa kontrata për marrjen me qira të pajisjeve për shfrytëzimin e tyre për këtë aktivitet të prokurimit.

Vlen të cekes se, sa i përket dokumenteve që kanë të bëjnë me listën e pajisjeve disa nga dokumentet (shembull: dokumenti unik doganor si dhe librezat e pajisjeve kanë një dukshmëri jo të mirë, megjithatë po ju paraqesim të gjeturat si më poshtë:

Sa i përket kërkesës së AK-së për listën e pajisjeve sipas pikës 2 të aneksit 7 të dosjes së tenderit, ku kërkohet: “Kamion me kran me peshë bartëse deri 3 t”, lidhur me këtë kërkesë, OE i rekomanduar ka prezantuar Kamion Modeli: MAN, Kamion me Kran me sy dyer me Targa 01-376-JG, pesha maksimale e ngarkesës së lejuar 13300.

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, duke qenë se AK në dosjen e tenderit përkatësisht në pikën 2 të aneksit 7 ka kërkuar “Kamion me kran me peshë bartëse deri 3 t”, me këtë rast sipas këtij përshkrimi, AK ka kufizuar që pesha bartëse e kamionit të jete deri 3 ton, rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontratë me pajisjet e prezantuara në këtë listë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht pikën 2 të aneksit 7. Për faktin se, pajisjet e prezantuar nga OE i rekomanduar kalojnë peshën bartëse deri 3 ton.

Gjithashtu, sa i përket kërkesës së AK-së për listën e pajisjeve sipas pikës 3 të aneksit 7 të dosjes së tenderit, ku kërkohet: “Ekskavator mobil – skip”, lidhur me këtë kërkesë OE i rekomanduar ka bashkangjitur dokumentin unik doganor për këtë pajisje/makinë me të dhënat si vijon: “Ngarkues (Skraper) i përdorur, “Marka: JCB; Tipi: 3CX-4T...”, andaj sipas kërkimeve në internet me këto të dhëna të pajisjes rezulton se behet fjale për ekskavator, si i tillë konsideroj se e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht pikën 3 të aneksit 7.

Ndërsa,

Sa i përket kërkesës së AK-së për listën e pajisjeve sipas pikës 4 të aneksit 7 “Lugë ngarkuese deri në 3 ton”, lidhur me këtë kërkesë OE i rekomanduar ka prezantuar modelin e Lugës ngarkuese me të dhënat si vijon:

Gjithashtu për këtë pajisje OE i rekomanduar ka prezantuar një “kontratë për qiraje” për Lugën ngarkuese, mirëpo nuk ka bashkangjitur të dhëna tjera sa i përket specifikave për lugën

përkatëse.

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, meqenëse është plotësu aneksi 7 me të dhënat për pajisjet përkatëse, gjithashtu meqenëse OE i rekomanduar në ofertën e tij ka prezantuar modelin e lugës ngarkuese, AK mund të kërkojë sqarime- dëshmi shtese nga OE i rekomanduar për ta sqaruar modelin e lugës ngarkuese, se e njëjta i përgjigjet kërkesës së dosjes së tenderit përkatësisht pikës 4 të aneksit 7.

Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të LPP-se, AK mund të kërkojë nga OE që të dorëzojë, plotësojë, sqarojë apo kompletojë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Sa i përket kërkesës së AK-së për listën e pajisjeve sipas pikës 5 të aneksit 7 të dosjes së tenderit, ku kërkohet: “Mini eskavator 1-2 ton me pjesë përcjellëse qekan dhe lugë”, lidhur me këtë kërkesë OE i rekomanduar ka bashkangjitur dokumentin unik doganor, për këtë pajisje/makineri me të dhënat si vijon: Marka: Volvo, Tipi: L150F, Kw 210 Nr Serik: 17258...”, mirëpo, përveç të dhënave të lartë cekura, në dokumentin unik doganor mungojnë përshkrimet për pjesët përcjellëse si qekan dhe luge ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit përkatësisht në pikën 5 të aneksit 7 “Mini eskavator 1-2 ton me pjesë përcjellëse qekan dhe lugë”. Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se, pajisja –makineria si e tillë e prezantuar nga OE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht pikën 5 të aneksit 7.

PO ashtu, sa i përket kërkesës së AK-së për listën e pajisjeve sipas pikës 6 të aneksit 7 të dosjes së tenderit, ku kërkohet: “Auto fshese speciale deri në 3 t”, lidhur me këtë kërkesë OE i rekomanduar ka prezantuar pajisjen-makinerinë si vijon: Modeli: “Multicar M30 Kamion për pastrimin e rrugëve nga bora me dy dyer me Targa 03-842-EE”.

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, kjo pajisje është vetëm në kuadër të peshës së kërkuar sipas pikës 6 të aneksit 7 të dosjes, megjithatë si e tillë, sipas përshkrimit të kësaj pajisje është vështirë për të konstatuar se e njëjta pajisje-makineri kryen të njëjtat funksione të një “Auto fshese speciale” sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Rrjedhimisht bazuar në sqarimet e lartpërmendura, sa i përket pikës 2, 4, 5 dhe 6 të aneksit 7 të dosjes së tenderit, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor 5: OE ankues pretendon se, “5 Ka shperputhje ne mes te deklarimit me shkrim te afatit kohor te kryerjes se punimeve (GOE kane deklaruar se per 240 dite do te kryejne punimet) ndersa ne planin dinamik te ofruar kane prezantuar 238 dite, qe nenkupton, se ky GOE nuk mund te poentohet sipas kriterit te dosjes ku thuhet se afati minimal duhet te jete 240 dite. te gjitha mangesi ne deshmimin e kapacitetit profesional te kompanise se referuar si ofertues i suksesshem, jane te mjaftueshme per te eliminuar kete GOE pasi eshte i papergjegjshem per tu kualifikuar per kete kontrate”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 5:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE te rekomanduar per kontrate “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, lidhur me këtë sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka përcaktuar Kriterin për dhënien e kontratës “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm ” duke përcaktuar edhe nën kriteret si më poshtë:

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë sqaron se, Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Kështu qe, sa i përket kërkesës se lartcekur ne dosjen e tenderit për Planin Dinamik te punimeve, kërkesë e AK-se për Operatorët Ekonomik ka qene afati i implementimit si dhe periudha garantuese. Pra përveç kërkesës se cekur me larte, AK nuk ka kërkuar ndonjë aneks shtese për zbërthimin e planit dinamik te punimeve. Andaj OE i rekomanduar për kontrate ka plotësuar Deklaratën për Afatin e Implementimit te këtij projekti si dhe periudhën garantuese sipas kërkesës ne dosjen e tenderit. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues ne këtë pike është i pabazuar.

Provë Deklarata:

Pretendimet ankimore te OE ankues kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK:

Pretendimi ankimor 1: “OE ankues pretendon se Ne dosjen e tenderit, kerkohet qe paisjet te cilat merren me qera per kete projekt, duhet te deshmoen me marreveshje te noterizuar ne mes te qiradhenesit dhe qiramarrësit. Kompania ne fjale nuk e ka te noterizuar ne mes te qiradhenesit dhe qiramarrësit. por vetem nje person ka noterizuar kontratat - mos perpmbajtje e kriterit ne teresi.

Përgjigje Pretendimit ankimor 1:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:“ 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 te DT.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:5.OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit”.

Bazuar në kërkesën e lartcekur ne dosjen e tenderit, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues OE “FRONI 1” SH.P.K., kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK, lidhur me këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se, te gjitha kontratat për dhënien ne shfrytëzim te pajisjeve te dorëzuara OE- OLTİ TRASİNG SHPK janë te nënshkruara nga qiradhënësit dhe qiramarrësit dhe te cilat janë te noterizuara me ane te se cilës vërtetohen kontratat e palëve për dhënien ne shfrytëzim te pajisjeve respektive. Andaj si te tilla konsideroj se e plotësojnë kërkesën e dosjes se tenderit. Prandaj bazuar në sqarimet dhe dëshmitë e lartpërmendura ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se, “2. Kompania kur ka prezantuar paisjet, nuk ka paraqitur dokumentat adekuate per ekskavatorin 1 deri 2 ton, por vetem nje fature e cila eshte leshuar ne muajin e 11 te vitit 2023. pervec kesaj edhe ne fature nuk ka paraqitur se jane edhe luga dhe cekani si pjese percjellëse dhe kerkese e dosjes se tenderit”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 2:Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:Sa i përket kërkesës se AK-se për listën e pajisjeve sipas pikës 5 te aneksit 7 te dosjes se tenderit, ku kërkohet: “Mini eskavator 1-2 ton me pjesë përcjellëse qekan dhe lugë”, lidhur me këtë kërkesë OE OLTİ TRASİNG SHPK ka paraqitur te dhënat si me poshtë:

Eksperti shqyrtues sqaron se, meqenëse OE- OLTİ TRASİNG SHPK ne ofertën e tij për këtë pike ka paraqitur marrëveshjet për pajisjet te cilat do te përdoren për këtë projekt si dhe faturën nr. 10/2023 te datës 03.11.2023 ne te cilën emërtimi i faturës është:“ Minieskavaror 1-2 tonë me pjesë përcjellëse qekan dhe lugë”.

Fatura:

Megjithatë, meqenëse është plotësu aneksi 7 me te dhënat për pajisjet përkatëse, lidhur me këtë, AK sipas nenit 59 dhe 72 te LPP-se mund te kërkoj sqarime- dëshmi shtese nga OE lidhur me te dhënat për pajisjen –ekskavatorin 1 deri 2 ton për ta sqaruar se te dhënat e paraqitura nga OE e plotësojnë ose jo piken 5 te aneksit 7 te dosjes se tenderit.

Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të LPP-se, AK mund të kërkoj nga OE që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnëndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Duke marrë parasysh sqarimet e lartë cekura, pretendimi i OE ankues ne këtë pike është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se, “3. Mungon autofshesa deri 3 ton, sipas kërkeses se dosjes se tenderit”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 3: “Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:

Sa i përket kërkesës se AK-se për listën e pajisjeve sipas pikës 6 te aneksit 7 te dosjes se tenderit, ku kërkohet: “Auto fshese speciale deri në 3 t”, lidhur me këtë kërkesë OE OLTİ TRASİNG SHPK ka paraqitur te dhënat si me poshtë:

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, sa i përket pajisjeve te paraqitura nga OE OLTİ TRASİNG SHPK për piken 6 te aneksit 7 te dosjes, sipas përshkrimit te pajisjeve te paraqitura është vështirë për te konstatuar se këto pajisje-makineri i përgjigjen kërkesës ne dosjen e tenderit, si dhe kryejnë te njëjtat funksione te një “Auto fshese speciale” siç është kërkuar ne dosjen e tenderit. Prandaj, bazuar ne sqarimet e lartpërmendura, pretendimi i OE ankues ne këtë pike është i bazuar.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues pretendon se, “4. Ka shperputhje ne mes te deklarimit me shkrim te afatit kohor te kryerjes se punimeve (GOE kane deklaruar se per 240 dite do te kryejne punimet) ndersa ne planin dinamik te ofruar kane prezantuar 224 dite, qe nenkupton, se ky GOE nuk mund te poentohet sipas kriterit te dosjes ku thuhet se afati minimal duhet te jete 240 dite”

Përgjigje Pretendimit ankimor 4: “Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka përcaktuar Kriterin për dhënien e kontratës “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm ” duke përcaktuar edhe nën kriteret si më poshtë:

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë sqaron se, Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të

kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Kështu që, sa i përket kërkesës së lartcekur në dosjen e tenderit për Planin Dinamik të punimeve, kërkesë e AK-së për Operatorët Ekonomikë ka qenë afati i implementimit si dhe periudha garantuuese. Pra përveç kërkesës së cekur më lartë, AK nuk ka kërkuar ndonjë aneks shtesë për zbërthimin e planit dinamik të punimeve. Andaj OE- OLTÏ TRASING SHPK ka plotësuar Deklaratën për Afatin e Implementimit të këtij projekti si dhe periudhën garantuuese sipas kërkesës në dosjen e tenderit. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pabazuar.

Provë Deklarata:

Pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt OE -EING COM:

Pretendimi ankimor 1: “OE ankues pretendon se “edhe pse është me cmimin më të lartë, gjithashtu, ka mangësi në dosjen e prezantuar: 1. Mungon plani dinamik “.

Përgjigje Pretendimit ankimor 1:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt OE -EING COM”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka përcaktuar Kriterin për dhënien e kontratës “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm” duke përcaktuar edhe nën kriteret si më poshtë:

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë sqaron se, Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Kështu që, sa i përket kërkesës se lartcekur ne dosjen e tenderit për Planin Dinamik të punimeve, kërkesë e AK-se për Operatorët Ekonomikë ka qenë afati i implementimit si dhe periudha garantuuese. Pra përveç kërkesës se cekur me lartë, AK nuk ka kërkuar ndonjë aneks shtesë për zërthimin e planit dinamik të punimeve. Andaj OE -EING COM ka plotësuar Deklaratën për Afatin e Implementimit të këtij projekti si dhe periudhën garantuuese sipas kërkesës në dosjen e tenderit. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pabazuar.

Provë Deklarata:

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se, “ 2. Mungon autofshesa me peshe maksimum 3 ton. Në nuk kemi hulumtuar, por sikur të studionim me shumë do të gjenim akoma të gjetura.”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 2:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt OE- OE - EING COM”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim:

Sa i përket kërkesës së AK-se për listën e pajisjeve sipas pikës 6 të aneksit 7 të dosjes së tenderit, ku kërkohet: “Auto fshese speciale deri në 3 t”, lidhur me këtë kërkesë OE -EING COM ka prezantuar pajisjen-makinerinë si vijon: Modeli Citymaster 1250 “Aut. Spec. për pastrimin e rrugëve me dy dyer me Targa 06-995-ES”.

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, pajisja e lartcekur e prezantuar nga OE -EING COM, sipas specifikave të kësaj pajisje e njëjta rezulton se i përgjigjet kërkesës së dosjes së tenderit përkatësisht pikës 6 të aneksit 7 të dosjes. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pabazuar.”

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “EING COM” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0270 ka vlerësuar se:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit të

kurvizit „Dardani”, me numër të prokurimit: 616-23-13568-5-1-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,235,000.00 €

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 06.12.2023, Ndërsa Formulari standard për korrigjimin e gabimeve B54 ne njoftimet e publikuara me datë 04.01.2024, 12.01.2024, 23.01.2024, 25.01.2024 dhe - 02.02.2024.

AK me datë 06.03.2024 ka publikuar Vendimin dhe Letrat Standarde per OE-të, kundër vendimit të AK-së me datë 11.03.2024, OE “EING COM” SH.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

Ndërsa, AK me datë 19.03.2024 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 27.03.2024 OE “EING COM” SH.P.K., ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.”

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2024/0270 në pajtim me nenin 114 të LPP së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

AK me datë 06.03.2024, përmes Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Letrës standarde, ka njoftuar Operatorët Ekonomik pjesëmarrës për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, njëherit edhe parashtruesi i ankesës OE “EING COM” SH.P.K., është njoftuar me rezultatin për këtë aktivitetit të prokurimit. Sipas vendimit të lartcekur të AK-së OE ankues është i pasuksesshëm me 85.92% të pikëve të fituara.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues, Eksperti shqyrtues sqaron se, AK ne refuzimin e kërkeses për rishqyrtim nuk ka dhene sqarime konkrete ne pretendimet ankimore. Sipas paragrafit 9 të nenit 108/A të LPP-se, percaktohet qartë se, “Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim”.

Gjithashtu kurdo që refuzohet një kërkesë për rishqyrtim, edhe neni 62.2 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton:“62.2 Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit.

Pretendimi ankimor 1: “OE ankues pretendon se GOE” Selmans Network SHPK & Infra-Plus SH.P.K. nuk ka plotesuar kerkesat administrative pasi nuk ka plotesuar formulrin e tenderit si duhet. Cmimi total i tenderit eshte: 941,133.28 Eurondersa sipas tabelës nuk eshte plotesuar siq duhet”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 1: “Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE te rekomanduar për kontrate “Selmans Network SHPK & Infra-Plus SH.P.K”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim: Sa i perket plotesimit te formulrit te tenderit nga OE i rekomanduar per kontrate, shihet se ne tabelen e nenkriterëve eshte bere gabim duke e ndare cmimin e ofertës ne nenkriterë. Lidhur me kete gabim te OE sqarojme se, meqenese cmimi perfundimtar/cmimi total korrespondon me cmimin e dhene në Përshkrim të çmimeve si dhe eshte plotesuar peridha garantuese dhe plani dinamik nga OE i rekomanduar per kontrate sipas kerkesës se dosjes se tenderit , si tille ky gabim mund te konsiderohet vetem si gabim teknik i cili nuk ndikon ne ndryshimin e kushteve dhe kërkesave të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe si i tille nuk krijon ndonje konfuzion ne raport me vleresimin e tenderit dhe/ose implementimin e kontrates. Megjithate, eshte ne pergjegjesine e AK-se qe gjate vleresimit dhe krahasimit te tendereve gjithmone duhet ta kete parasysh qelimin e ligjit, andaj konform paragrafit 4 te nenit 59 të LPP-së AK mund të vlerësojë të pranueshme devijimet me kushtin që devijimet të kuantifikohen dhe OE-të të trajtohen barabartë sipas nenit 7 të LPP-së.

Bazuar ne sqarimet e cekura me larte, pretendimi i OE ankues kundrejt GOE te rekomanduar për kontrate ne këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2:“Kerkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj certifikatat ISO STANDARD si në vijim a)ISO 14001 2015, b) ISO 45001 2018 , c) ISO 9001-2015

Deshmia3. Kopje e Certifikatave ISO 14001 2015, ISO 45001 2018, ISO 9001-2015 me validitet”.

“Certifikatat ISO jane ofruar vetem nga lideri i grupit, ,irepo nuk ka paraqit ISO standardet dhe per anetarin e grupit, duke u bazuar ne Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik neni 26Grupi i Operatoreve Ekonomik, paragrafi 26.6 certifikatat për sigurimin e cilësisë, permenden ne nenin 70 te LPP-se dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik

me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 2: “Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK & Infra-Plus SH.P.K”, lidhur me këtë pretendim ankimor sqarojmë si në vijim: Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale: “3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj certifikatat ISO STANDARD si në vijim a)ISO 14001 2015, b) ISO 45001 2018 , c) ISO 9001-2015.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:3. Kopje e Certifikatave ISO 14001 2015, ISO 45001 2018, ISO 9001-2015 me validitet”.Bazuar në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, Eksperti shqyrtues sqaron se, sa i perket certifikatave për sigurimin e cilësisë, të cilat përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe nenin 26.6 të RRPP-se dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, KRPP ka dhene nje interpretim i cili eshte i publikuar ne platformen E-prokurim tek “Pyetjet e shpeshta” (pyetja me nr 29) citojme:

“29. 22.06.2023 Sipas nenit 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, në rast se AK kërkon Certifikatë që vërteton përshtatshmërinë e produktit me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, në rast grupi të operatorëve, certifikata e tillë a duhet të kërkohet nga të gjithë anëtarët e grupit apo mjafton njëri nga ata të jetë i pajisur me këtë certifikatë?

Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, “Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse

Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse”.

Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001..., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohej në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit.

Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillen nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit.

Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre”.

Eksperti sqaron se, duke u bazuar në dispozitat e ligjit dhe legjislacionit dytesor për prokurim publik si dhe duke marrë parasysh interpretimin e lartcekur, është fakt që në rast se AK kërkon certifikatat për standardet e caktuara sipas nenit 70 të LPP-së dhe nenit 26.6 të RRPP-së, dëshmitë për standardet përkatëse duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre. Mirepo, duke marrë parasysh pjesën e fundit të interpretimit të lartcekur të dhënë nga KRPP, thuhet se: “AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre”, në rastin konkret, AK këto kërkesa nuk ka specifikuar se vetëm nga njëri anëtar apo nga të gjithë anëtarët e grupit duhet të sillen dëshmitë për certifikatat përkatëse, andaj në bazë të kërkesës së dosjes së tenderit, meqenese Standardet përkatëse “ISO 14001 2015, b) ISO 45001 2018 ,C) ISO 9001-2015” janë

vendosur te kërkesat 9.1 & 9.2 e te cilat bëjnë pjese te aftësia teknike dhe profesionale ma konkretisht te neni 69 i LPP-së e qe per te cilat AK nuk ka specifikuar se nga të gjithë anëtarët e grupit duhet te ofrohen deshmite perkatese, atehere çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-se do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Kjo per faktin se: Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton:“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Prandaj, bazuar ne sqarimet e cekura me larte, pretendimi i OE ankues kundrejt GOE te rekomanduar për kontrate ne këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3: “Kerkesa 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 te DT

Deshmia e kerkuar: OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit”.

Sipas kerkeses se AK eshte kerkuar Kamion me kran me peshe bartese deri ne 3 t, OE ka ofruar kamion kiper me targa 01-376-JG ku pesha maximale per kete kamion sipas librezes shihet qe eshte 13300 kg apo 13.3t, dmth qe OE nuk ka ofruar makinerine ne fjale sipas kerkeses se AK-se...”.

Per makinerit:

3. Ekskavator mobil – skip.

4. Lugë ngarkuese deri ne 3 t.

7.Mjet veteshkaterrues (damper)2-3 m3

OE nuk ka dorezuar libezen e qrkullimit per pajisjen ne fjale ku kerkese ka qene duhet ti bashkangjitet libreza valide.

Te gjitha makinerit te cilat i nenshtrohen LIGJIT Nr. 05/L132 ligji per automjete, duhet te jene te regjistruara dhe me afat te regjistrimit.

6. Auto fshese speciale deri 3 t, OE ka ofruar kamion per pastrimin e rrugeve nga bora me targa 03-842-EE ku pesha maximale per kete kamion sipas librezes shihet qe eshte 5000 kg apo 5t, dmth qe OE nuk ka ofruar makinerin ne fjale sepas kerkeses se AK-se sepse eshte kerkuar pesha totale dhe jo pesha e ngarkeses.

Si perfundim G.O.E.“Selmans Network SHPK & Infra-Plus SH.P.K nuk ka plotesuar kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale andaj duhet te vleresohet si i papergjegjshem”.

Përgjigje Pretendimit ankimor 3:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE te rekomanduar për kontrate “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, lidhur me këtë sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, ka përcaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:“ 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 te DT.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

5.OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit”.

Lidhur me kete pretendim ankimor të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë “Selmans Network SHPK dhe Infra-Plus SH.P.K”, sqarojme:

Bazuar ne kërkesën e lartcekur ne dosjen e tenderit, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht ofertës se OE te rekomanduar, Eksperti shqyrtues sqaron se, lista e pajisjeve e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate e përshkruar me te dhëna rreth pajisjeve përkatëse si dhe ka prezantuar edhe disa kontrata për marrjen me qira te pajisjeve për shfrytëzimin e tyre për këtë aktivitet te prokurimit.

Sa i përket kërkesës se AK-se për listën e pajisjeve sipas pikës 2 te aneksit 7 te dosjes se tenderit, ku kërkohet: “Kamion me kran me peshë bartëse deri 3 t”, lidhur me këtë kërkesë, OE i rekomanduar ka prezantuar Kamion Modeli: MAN, Kamion me Kran me dy dyer me Targa 01-376-JG, pesha maksimale e ngarkesës se lejuar 13300.

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, duke qene se AK ne dosjen e tenderit përkatësisht ne piken 2 te aneksit 7 ka kërkuar “Kamion me kran me peshë bartëse deri 3 t”, me këtë rast sipas këtij përshkrimi, AK ka kufizuar qe pesha bartëse e kamionit te jete deri 3 ton, rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontrate me pajisjet e prezantuara ne këtë liste nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit përkatësisht piken 2 te aneksit 7. Për faktin se, pajisjet e prezantuar nga OE i rekomanduar kalojnë peshën bartëse deri 3 ton. Andaj, bazuar ne sqarimet e cekura me larte, pretendimi i OE ankues kundrejt GOE te rekomanduar për kontrate ne këtë pikë është i bazuar.

Ndersa, per makinerit:

3. Ekskavator mobil – skip.

4. Lugë ngarkuese deri ne 3 t.

7.Mjet veteshkaterrues (damper)2-3 m3

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar ne dokumentacionin e prezantuar ne oferten e OE te rekomanduat, per keto pajisje eshte dorezuar dokumenti unik doganor, fatura, por mungojne librezat e qarkullimit per pajisjet ne fjale. Andaj meqenëse është plotesu aneksi 7 me te dhënat për pajisjet përkatëse, gjithashtu meqenëse OE i rekomanduar ne ofertën e tij ka prezantuar listen e pajisjeve, AK per deshmitë lidhur me keto pajisje qe plotesojne kushtet për regjistrim dhe pjesëmarrje në trafik rrugor, mund te kërkoj sqarime- dëshmi shtese nga OE i rekomanduar (librezat valide) sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të LPP-se, AK mund të kërkoj nga OE që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Pretendimi i OE ankues kundrejt GOE te rekomanduar për kontrate ne këtë pikë është i bazuar.

Ndërsa,

Sa i përket kërkesës se AK-se për listën e pajisjeve sipas pikës 6 te aneksit 7 te dosjes se tenderit, ku kërkohet: “Auto fshese speciale deri në 3 t”, lidhur me këtë kërkesë OE i rekomanduar ka prezantuar pajisjen-makinerinë si vijon: Modeli: “Multicar M30 Kamion për pastrimin e rrugëve nga bora me dy dyer me Targa 03-842-EE”

Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues sqaron se, sic shihet kjo pajisje është ne kuadër te peshës se kërkuar sipas pikës 6 te aneksit 7 te dosjes, megjithatë si e tille, sipas përshkrimit te kësaj pajisje është vështirë për te konstatuar se e njëjta pajisje-makineri i pergjigjet kërkesës se dosjes se tenderit. Andaj pretendimi i OE ankues kundrejt GOE te rekomanduar për kontrate ne këtë pikë është i bazuar.

Pretendimet ankimore te OE ankues kundrejt OE- “ALFA.i” SHPK:

Eksperti shqyrtues sqaron se, lidhur me OE-“ALFA.i” SHPK, sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 06.03.2024, është eliminuar dhe i njëjti nuk kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, rrjedhimisht nuk është palë me interes material në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK:

Përgjigje lidhur me këto Pretendime ankimore:

Eksperti shqyrtues i ka shqyrtuar këto pretendime ankimore të OE ankues, kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK”, lidhur me këto pretendime ankimore sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale: “ 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 të DT.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

5.OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit”.

Bazuar në kërkesën e lartcekur në dosjen e tenderit, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues kundrejt OE- OLTİ TRASİNG SHPK, lidhur me “kontratat për dhenien në shfrytëzim të pajisjeve” , Eksperti shqyrtues sqaron se, lista e pajisjeve e prezantuar nga OE “OLTİ TRASİNG SHPK”, e përshkruhet me të dhëna rreth pajisjeve përkatëse si dhe të bashkangjitura edhe kontratat për marrjen me qira të pajisjeve për shfrytëzimin e tyre për këtë aktivitet të prokurimit.

kontratat për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve të dorëzuara OE- OLTİ TRASİNG SHPK janë të nënshkruara nga qiradhënësit dhe qiramarrësit dhe të cilat janë të noterizuara me ane të cilës vërtetohen kontratat e palëve për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve respektive. Pra kontratat në fjalë përmbajnë elementet baze sipas kërkesës së dosjes, andaj si të tilla konsideroj se e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Prandaj bazuar në sqarimet dhe e lartpërmendura pretendimi i OE ankues sa i përket pikës nr. 1, 2, 3, 4, dhe 6 që kanë të bëjnë me kontratat për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve janë të pa bazuar.

Ndërsa,

Lidhur me pretendimin ankimor nr 6, eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në dokumentacionin e prezantuar në ofertën e OE - OLTİ TRASİNG SHPK, për pajisjen “Mjet vetëshkatërrues (damper)2-3 m³” Eshtë dorëzuar dokumenti unik doganor si dhe fatura, por mungon librezë e qarkullimit për pajisjen në fjalë.

Andaj meqenëse është plotësuar aneksi 7 me të dhënat për pajisjen përkatëse, gjithashtu meqenëse OE - OLTİ TRASİNG SHPK në ofertën e tij ka prezantuar listën e pajisjeve, AK për dëshmitë lidhur me këto pajisje që plotëson kushtet për regjistrim dhe pjesëmarrje në trafik rrugor mund të kërkojë sqarime- dëshmi shtesë nga OE (librezën valide) sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të LPP-se, AK mund të kërkojë nga OE që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Andaj pretendimi i OE ankues në këto pike është i bazuar.

Pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt GOE- “FRON 1” SHPK & “İLEAA-GR SHPK:

Lidhur me pretendimin e OE ankues se, “GOE “FRON 1” SHPK & “İLEAA-GR SHPK,ka ofruar Valeditetin e ofertes në kundërshtim me kërkesën në Dosjen e Tenderit -FDT- neni 21.1 ku kërkesa ka qenë: Periudha e vlefshmerisë së tenderit do të jetë 120 ditë, ndërsa G.O.E. ka

ofruar validitetin e ofertes ne periudh 150 ditë”.

Sa i perket ketij pretendimi ankimor, eksperti shqyrtues sqaron si ne vijim:

Lidhur me kete ceshtje, dispozitat e legjislacionit per prokurim publik permenden vetëm minimumin e ditëve për periudhën e validitetit. Afati kohor i këtyre ditëve (validitetit te tenderit dhe sigurimit te tenderit), fillon nga data e fundit të dorëzimit të tenderëve, dhe në këto raste është përgjegjësi e OE-ve që të sigurohen që validiteti i sigurimit te tenderit e mbulon periudhen e percaktuar ne përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pra nëse Operatori Ekonomik do te ofronte validitetin e tenderit nën minimumin e kërkuar nga AK (120 ditë), atëherë kjo do të ishte shkak për eliminim tij, por jo edhe e kundërta.

Prandaj, bazuar ne sqarimet e cekura me larte, pretendimi i OE ankues kundrejt GOE “FRON 1” SHPK & “ILEAA-GR SHPK ne këtë pikë është i pabazuar.

Përgjigje Pretendimit ankimor lidhur me librezat per pajisjet e ofruara nga GOE “FRON 1” SHPK & “ILEAA-GR SHPK:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, kundrejt GOE “FRON 1” SHPK & “ILEAA-GR SHPK, lidhur me këtë sqarojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, ka percaktuar kërkesat për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:“ 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 te DT.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

5.OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit”.

Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar ne dokumentacionin e prezantuar ne oferten e GOE “FRON 1” SHPK & “ILEAA-GR SHPK, per keto pajisje eshte dorezuar dokumentacioni si vijon:

-Per pajisjen “Ekskavator mobil – skip.” Eshte dorezuar dokumenti unik doganor, por mungon librezat e qarkullimit.

-Per pajisjen “ Lugë ngarkuese deri ne 3 t.” Eshte dorezuar dokumenti unik doganor si dhe kontrata per shitjen ndermejtuese, por mungon librezat e qarkullimit.

-Per pajisjen “Auto fshese speciale deri në 3 t” Eshte dorezuar dokumenti unik doganor si dhe kontrata e blerjese per keto pajisje, por mungon librezat e qarkullimit.

-Per pajisjen “Mjet veteshkaterrues (damper)2-3 m3” Eshte dorezuar dokumenti unik doganor si dhe urdherpagesa, gjithashtu per keto pajisje eshte bashkangjitur edhe nje dokument por nuk shihet mjaftueshem se a eshte librezat e qarkullimit a po jo.

Pra eksperti shqyrtues, sipas sqarimeve te lartpermendura, meqenese është plotesuar aneksi 7 me te dhënat për pajisjet përkatëse, gjithashtu meqenese GOE “FRON 1” SHPK & “ILEAA-GR SHPK ne ofertën e tij ka prezantuar listen e pajisjeve, AK per deshmitë lidhur me keto pajisje qe plotesojne kushtet për regjistrim dhe pjesëmarrje në trafik rrugor mund te kërkoj sqarime-dëshmi shtese nga OE (librezat valide) sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të LPP-se, AK mund të kërkoj nga OE që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.Pretendimi i OE ankues kundrejt GOE “FRON 1” SHPK & “ILEAA-GR SHPK ne këtë pikë është i bazuar.”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FRONI 1” SH.P.K., dhe OE ankues “EING COM” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertes shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertes shqyrtuese janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FRONI 1” SH.P.K., dhe OE “EING COM” SH.P.K. ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat e paraqitura në raportin e ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i operatorit ekonomik ankues “FRONI 1” SH.P.K., dhe “EING COM” SH.P.K. janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “FRONI 1” SH.P.K., aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit të kurrizit, Dardani” me nr. të prokurimit: 616-23-13568-5-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “EING COM” SH.P.K. aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit të kurrizit, Dardani” me nr. të prokurimit: 616-23-13568-5-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të

kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veprohet në plotin dhe dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që OE i cili është rekomanduar nga ana e AK, të kualifikohet si i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe lënda duhet të kthehet në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " FRONI 1 " SH.P.K., EING COM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: